



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË

04.05.2020

Trajtimi i hapësirave me interes publik - Suharekë			
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DOREZIM		PRIMLJENO - RECEIVED	
Nësisia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	17/168	2

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala, zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim ZKA¹ dhe në PMK (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

N.P.Sh."Osmani", Mushtishtë, 23000, Suharekë, NUI 81031269 të cilën e përfaqëson Enver Osmani (në vazhdim) Operatori Ekonomik në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës:

TRAJTIMI I HAPËSIRAVE ME INTERES PUBLIK-SUHAREKË

Nr i prokurimit 624-020-13-521 & 624-020-871-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lëndë e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Trajtimi i hapësirave me interes publikë-Suharekë sipas pecifikimeve teknike të dosjes së tenderit.

1.2 Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 9 ditë pune nga pranimi i urdhërësës nga menaxheri i kontratës. Ndërsa për shkak të natyrës së punës së projektit dhe artikujve sezonal, kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e vlefshme deri në 9 muaj nga kjo datë, kur edhe përfundon komplet projekti.

1.3 Operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës për një periudhë prej 10 muajsh.

1.4 E.O është i obliguar të bashkëpunojë me menagjerin e kontratës të Autoritetit Kontraktues dhe zyrën e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menagjerin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 17.820,00 € (Shtatëmbëdhjetë mijë e teteqind e njëzetë euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE.

2.5 Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10% vlerës së kontratës do të bëhet me raportin e mbikëqyrësit dhe menaxherit të projektit dhe raportin e pranimit teknik nga komisioni

¹ ZAK – Zyrtari Kryesor Administrative

përkatës për kryerjen e punimeve .

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.



4.5 Numri kontaktues i OE është **049 265 723**

E-mail: **enver-osmani@live.com**

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	04/05/2020
Vula	vv 

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Enver Osmani
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data:	04/05/2020
Vula	vv 

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	TRAJTIMI I HAPËSIRAVE ME INTERES PUBLIK-SUHAREKË Nr i prokurimit 624-020-013-521&624-020-871-521
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 10 muaj .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i

		pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë nga data e pranimi te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nenshkrimit te kontrates, nese nuk specifikohet ndryshe ne PKM.
	17.2	Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 10 ditë pune nga pranimi i urdhëresës nga nga menaxheri i kontratës. Ndërsa për shkak të natyrës së punës së projektit dhe artikujve sezonal, kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e vlefshme deri në 9 muaj nga kjo datë, kur edhe përfundon komplet projekti.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit i caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe në PMK
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Vërtetimet e pagesë	28	28.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit. 28.2. Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë.
Përgjegjësia mbi	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimi teknik.

Defektet		
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	N.P.Sh. " Osmani ", Mushtishtë, 23000, Suharekë, Kosovë
Lënda:	DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	04/05/2020

I/e nderuar,

Kjo deklaratë bëhet në pajtim me Kontratën:

TRAJTIMI I HAPËSIRAVE ME INTERES PUBLIK-SUHAREKË
Nr i prokurimit 624-020-013-521 /-624-020-871-521

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit teknik ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit : Enver Osmani Nënshkrimi E. Osmani

DATA: 04/05/2020



Osmicini

TRAJTIMI I HAPËSIRAVE - SUHAREKË -					
Nr.	Përshkrimi i Pozicionëve	Njesia	Sasia	Çmimi për Njesi	Çmimi total me TVSH
1 PUNIMET PËRGATITORE					
1.1	Organizimi dhe sigurimi i vendpunishteve, planifikimi i hapësirave, pastrimi, shënjëzimi sipas nevojës dhe largimi i dheut të papërdorshëm dhe mbeturinave eventuale.	komplet	1.00	50.00	50.00
1.2	Furnizimi dhe mbjellja e luleve sezonale të ngjyrave të ndryshme (ngjyrat i përcakton organi mbikëqyrës). Lulet duhet të kenë lartësi minimale 10-15 cm si dhe zhvillim paraprak të mjaftueshëm para mbjelljes në hapësira publike të caktuara nga AK. Fillimisht duhet te behet largimi i dheut te papërdorshëm dhe përgaditja e hapësirës për mbjellje. Në cmim gjithashtu te llogaritet furnizimi me dheun adekuat per mbjellje e luleve dhe ujitja e tyre.	copë	15000.00	0.25	3750.00
1.3	Furnizimi dhe montimi i vazove me mbajtëse me nga min. 4 lule dekorative për secilën vazë me gjatësi minimale të vazos 60 cm. Ngjyrat e vazove dhe të luleve i përcakton AK. Lulet duhet të kenë zhvillim paraprak të mjaftueshëm.	copë	200.00	5.00	1000.00
1.4	Furnizim me dhe humusor duke përfshirë rrafshimin, ngjeshjen, nivelizimin si dhe furnizimi dhe mbjellja e barit holandez ne hapsirat e caktuara per gjelbrim.	m²	3000.00	1.50	4500.00
	Furnizimi, transporti, mbjellja e drunjëve sipas specifikimit më poshtë duke pasë parasysh format e kurorës dhe llojin e tyre, të definohet largësia nga trotuarët, nga rrugët dhe nga njëra tjetra. Paraprakisht të përpunohet pika e mbjelljes, të plotësohet me dhe adekuat. Drunjët të jenë si të specifikuara në përshkrim (jo të dëmtuar) dhe me etiketë rreth llojit të tyre. Për cdo hapësirë të dëmtuar, te kthehet ne gjendjen e mëparshme pa kompensim. Drunjët duhet të jenë të përforcuar me konstrukcion të drurit.				
1.5	Furnizimi dhe mbjellja e fidaneve: Bli, Rrap, Katalpa Lartësia e drurit nga toka deri në degëzimet e para të jenë 2,20 - 2.50 m, me kurorë të formuar deri në 3,50 m lartësi. Perimetri i trungut nga toka e deri në 1 m lartësi të jetë 14-16 cm. Druri duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe' humusor dhe sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-60 litra.	cope	40.00	18.00	720.00

1.6	Furnizimi dhe mbjellja e fidaneve: Kumbull apo qershi dekorative. Lartësia e drurit nga toka deri në degëzimet e para të jenë 2,20 - 2.50 m, me kurorë të formuar deri në 3,50 m lartësi. Perimetri i trungut nga toka e deri në 1 m lartësi të jetë 14-16 cm. Druri duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe' humusor dhe sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-60 litra.	cope	30.00	20.00	600.00	✓
1.7	Furnizimi dhe mbjellja e tujave tajlandeze me lartësi minimale 1.5m.	copë	600	10	6000.00	✓
1.8	Furnizimi dhe mbjellja e Shkurreve me lartësi min.1m dhe kurora min 60cm. Format dhe llojet përcaktohen nga organi mbikëqyrës.	copë	300.00	4.00	1200.00	✓
	Në të gjitha çmimet duhet të përfshihet mirembajtja e hapësirës dhe ujitja e hapësirave gjelbruese, luleve dhe drunjëve dekorative si dhe sipas nevojës krasitja e drunjëve, plehërimi dhe zëvendësimi i njesive të lartcekura të cilat nuk kanë zhvillim deri në përfundim të projektit sipas kontrates.					✓
Totali me TVSH					17820.00	